



"Tung Tung" në Sofrën Ilire

Shkup, 17 qershor - Grupi i njohur nga Shkupi "Tung Tung" ka qenë i ftuar për të performuar në manifestimin "Sofra ilire" që organizohet prej gjashtë vjetësh në lokalitetin antik të Apollonisë në Fier. Grupi ka interpretuar disa nga hitet e tij, në një koncert që ka zgjatur rreth 40 minuta. Në kuadër të koncertit, kanë interpretuar edhe artistët e Teatrit Kombëtar, Valbona Imami dhe Dritan Boriqi, një recital me poezi të autorëve shqiptarë dhe të huaj. "Tung Tung" ka interpretuar

pjesë të zgjedhura nga albumet në vite, si dhe dy pika xhaz evergreen.

Manifestimi "Sofra ilire", ka si synim kryesor afirmimin e lokacioneve arkeologjike, në rajonin e Fierit, në funksion të turizmit. Manifestimi ka zgjatur tre ditë në Divjakë, Bylis dhe Apolloni, me pjesëmarrjen e artistëve të zhanreve të ndryshme si piktorë, fotografë, skulptura, dramë, recitale, muzikë e të tjera. Në manifestim ishte i pranishëm me ekspozitë edhe fotografi nga Maqedonia Osman Demiri.